



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Ante-Group” shpk

Adresa: Lagjja “22 Tetori” Rruga Antipatrea, Zona Kadastrale 8502, numri i pasurisë 11/82, godinë 7- katëshe, kati i 3 BERAT.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim” ”Rindërtimi pjesor i murit mbajtës (pas shkarjes) – Varrezat e Dëshmorëve”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-87453-09-26-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: ”Rindërtimi pjesor i murit mbajtës (pas shkarjes) – Varrezat e Dëshmorëve”.

Fondi limit: 4,289,462 (katër milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion me VKB Nr.63, datë 07.06.2018 ”Për disa ndryshime në VKB Nr. 132 datë 21.12.2017, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018” (i ndryshuar).

Kohëzgjatja e kontratës: 20 (njëzet) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 08.10.2018 Ora: 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 39 datë 01.10.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik “Ante-Group” sh.p.k** NUIS J62904100D

Vlera e ofertës = **4,159,086.75** (katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

2. **Bashkimi i operatorëve ekonomikë “KMK” sh.p.k & “Sardo” sh.p.k**

NUIS L78223801E
NUIS

K13120402W

Vlera e ofertës = **3,378,874** (tre milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

3.Operatori ekonomik “Cara” shpk

NUIS

K07729920F

Vlera e ofertës = **3,437,802** (tre milionë e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dy) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Arba & Trans - 2010” sh.p.k

NUIS

L02325001T

Vlera e ofertës = **3,885,382** (tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1.Bashkimi i operatorëve ekonomikë “KMK” sh.p.k & “Sardo” sh.p.k

2. Operatori ekonomik “Cara” shpk

3.Operatori ekonomik “Arba & Trans - 2010” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “KMK” sh.p.k & “Sardo” sh.p.k

NUIS L78223801E

NUIS K13120402W

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **3,378,874** (tre milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë. Çmimi total i ofertës me TVSH = **4,054,649** (katër milion e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzet e nënte) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 20 (njëzet) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se listpagesat e paraqitura nga Shoqëria

“Sardo” sh.p.k për periudhën Shkurt 2018 – Gusht 2018 nuk janë të shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4.

- KVO pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjekun e përgjithshëm konstatoi se mjeku i deklaruar nga shoqëria “Sardo” sh.p.k me initiale A.H nuk është i pajisur me Urdhër mjeku, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës pllakashtrues dhe konkretisht D.H i punësuar pranë shoqërisë “K.M.K” sh.p.k. KVO pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për punonjësën e sipërcituar konstatoi se nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:*
 - a. 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
 - b. 1 (një) punonjës hidraulik
 - c. 1 (një) punonjës pllakashtrues
 - d. 1 (një) punonjës saldator
 - e. 2 (dy) punonjës muratorë
- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.”
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “K.M.K” sh.p.k & “Sardo” sh.p.k ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamionçina përkatësisht me targa AA 866 RM; si dhe AA 870 EK. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruar si më lart, KVO konstatoi se Kamionçina me targë AA 866 RM ka kapacitet mbajtës 5.3 Ton ndërsa mjeti me targë AA 870 EK ka kapacitet mbajtës 3.2 Ton. Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “K.M.K” sh.p.k & “Sardo” sh.p.k nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “K.M.K” shpk & “Sardo” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere me targë AA 621 PA. KVO, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin e sipërcituar, konstatoi se Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit lëshuar nga institucioni përkatës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “a”.

- Gjithashtu referuar Shtojcës 9, Bashkimi i Operatorëve ekonomikë ka deklaruar se disponon 1 (një) Autopompë për hedhje betoni me targë DR 8324 E. KVO pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin e sipërcituar, konstatoi se Bashkimi i Operatorëve ekonomikë nuk ka paraqitur Aktin e pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “a”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “K.M.K” shpk & “Sardo” shpk, referuar Shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.
- **2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Cara” shpk**

NUIS

K07729920F

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **3,437,802** (tre milionë e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dy) lekë. Çmimi total i ofertës me TVSH = **4,125,362** (katër milion e njëqind e njëzet e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 20 (njëzet) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Operatori ekonomik “Cara” sh.p.k nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku (i vlefshëm), diplomë, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm”* pasi për mjekun e përgjithshëm, Urdhëri i Mjekut (leje individuale për për ushtrimin e profesionit për mjekë) rezulton i pavlefshëm. (lëshuar në datë 04.07.2012 ku leja është e vlefshme për 5 vjet dhe rinovimi bëhet 2 muaj përpara mbarimit të afatit). Komisioni I Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik “Cara” shpk nuk ka paraqitur dokumentin e rinovuar.
- Operatori ekonomik “Cara” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme),*

lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit” pasi Komisioni I Vlerësimit të Ofertave konstaton se është paraqitur dokumentacion për vetëm 1 (një) manovrator nga 2 (dy) të kërkuar.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet Autobetoniere, të deklaruar dhe paraqitur nga operatori ekonomik “Cara” shpk konstatoi se nuk është paraqitur foto për këtë mjet, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa “d”.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Arba & Trans - 2010” shpk

NUIS

L02325001T

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **3,885,382** (tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë. Çmimi total i ofertës me TVSH = **4,662,459** (katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë. Afati kohorë për kryerjen e punimeve është brenda 20 (njëzet) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Operatori Ekonomik “Arb& Trans - 2010” shpk në Licensën e Shoqërisë nuk ka të përfshirë NP-5A (Punime nëntokësore, ura e vepra arti), çka bie në kundërshtim me pikën 2, Kapaciteti teknik, të Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Operatori Ekonomik “Arb& Trans - 2010” shpk ka deklaruar të punësuar si Drejtuese Teknik, Inxhinierën e Ndërtimit O.Kapllani. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues, u konstatua se mungon Diploma, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3, ku përcaktohet se Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:
 - Librezë pune (përkatëse)
 - Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
- Operatori ekonomik “Arb & Trans - 2010” shpk nuk ka paraqitur “Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Shkurt 2018 - Gusht 2018, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, germa a).

- Operatori Ekonomik “Arb& Trans - 2010” shpk ka deklaruar të punësuar 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Pas verifikimit të dokumentacionit, u konstatua se mungojnë Dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) për të dy punonjësit Manovratorë, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarde të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8, ku përcaktohet se “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.*- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Arb& Trans - 2010” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Kamionë me kapacitet mbajtës minimumi 10 tonë”. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin me targa AA587LK , KVO konstatoi se ka mbaruar afati i vlefshmerisë së siguracionit të mjetit konkretisht me datë 22.05.2018. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Arb& Trans - 2010” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarde të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (aktin e pronësisë), b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: a) dokumenti qe vërteton regjistrimin e tij (aktin e pronësisë), b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirase/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi Shtojcën 9 (Deklaratën mbi disponueshmërinë e mjeteve) të paraqitur nga shoqëria “Arb& Trans - 2010” shpk, konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autovinç, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Ante-Group” sh.p.k**, me adresë: **Lagjja “22 Tetori”, Rruga Antipatrea, Zona Kadastrale 8502, numri i pasurisë 11/82, godinë 7- katëshe, kati i 3, BERAT**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **4,159,086.75** (katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 12.10.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje

të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

